



Pranim / Dorezuar Prilbena / Prilbena Received / Delivered	22.12.2022	2	viti god Year
Organ / Njësia Organi / Jedinstvo Org / Unit	SKUMSHCK	8372/2022	1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1009/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtare, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1009/2022 të datës 15.11.2022 të parashtruar nga ankuesit:

zyrtar të njësitit për përcjelljen e të burgosurve, me adresë  
kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1009/2022 e datës 15.11.2022 të parashtruar nga ankuesit

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.1101 i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit:

,të punësuar në pozitën "Zyrtar Korrektues" në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datë 15.11.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me numër protokollit 7095/2022, kundër vendimit me nr.1101 të datës 27.10.2022 të nxjerr



nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përkatësisht Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm, përmes këtij vendimi të gjithë zyrtarët korrektues të cilët janë të inkuadruar në Njësitin për përcjellje të burgosurve, pas mbushjes së moshës 50 vjeçare lirohen nga detyrat dhe përgjegjësit e NJPB-së, dhe të njëjtit kthehen në pozitat sipas kontratave të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa Institucioni me datë 05.12.2022 ka kthye përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7646/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.1009/2022 me numër të protokollit 7095/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 15.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 05.12.2022 me numër protokollit 7646/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kërkesë për përgjigjeje ne ankesë e datës 25.11.2022; Flet kthesë e datës 25.11.2022; Kontratë pune e ankuesit K.G e datës 14.06.2018; Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 17.04.2018; Vendim me nr.1101 i datës 27.10.2021; Rregullore e brendshme e punës SHKK Nëntor 2015; Rregullat e standardit të sjelljes së stafit të NJPB-së; Dispozitat përfundimtare anti-korrupsioni; Kontratë pune e [ ] Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 12.04.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 15.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 07.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Kontratë pune e [ ], Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 16.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje te kontratës e datës 08.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 12.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 16.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 08.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 08.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 15.05.2018; Kontratë pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 17.04.2018; Kontratë të pune e [ ]; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 15.05.2018; Rekomandim për përtëritje të kontratës e datës 12.04.2018;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me çështjen në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesve është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesit të caktuar në pozitën Zyrtar Korrektues sipas ripërtëritjes së kontratave të vitit 2018 të cilët tani janë në njësitin për përcjelljen e të burgosurve, me datën 15.11.2022 kanë parashtruar ankesën A.nr.1009 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 27.10.2022 (në të cilin vendim besojmë gabimisht është vendosë data 27/10/2021 në pjesën e sipërme të këtij vendimi) me nr.1101 të nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku përmes këtij vendimi të gjithë zyrtarët korrektues të cilët janë të inkuadruar në Njësitin për përcjellje të burgosurve, pas mbushjes së moshës 50 vjeçare lirohen nga detyrat dhe përgjegjësit e NJPB-së, dhe të njëjtit kthehen në pozitat sipas kontratave të punës, me pretendimet ankimore se ky vendimi është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nenin 6,7 dhe 8.



Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese ju referua edhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, dhe 2 si dhe nënparagrafet nga 2.1 deri në 2.5 ,ku shprehimisht është e definuar "1.Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1 kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2 të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3 rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4 zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5 transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve" ,dhe mbi këtë bazë ligjore ka konstatuar se Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.1101 i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10, ku Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së autorizohet të: "1.10. koordinojë funksionet administrative të SHKK-së, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin e personelit, trajnimin dhe aftësimin e personelit të SHKK-së në mirëmbajtjen e të dhënave, sistemin e telekomunikimit, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin, inxhinieringun dhe logjistikën " dhe nenin 12 paragrafi 1.10 ku përcaktohet se " nxjerrë vendime, rregulla dhe procedura të brendshme për SHKK-në, të parapara me legjislacionin në fuqi" ndërsa ky vendim është në pajtim edhe me Rregullen e Brendshme të Punës për Njësitin për përcjelljen e të burgosurve i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me nr.1439 datë 30.11.2015,ku në pikën 2.7 i referohet rregullave të standardit të sjelljes së stafit të NJPB-së, paragrafi 5 ku përcaktohet se:" Staf i NJPB-së për nga mosha nuk lejohet të ngarkohet me këto përgjegjësi pas moshës 50 vjeçare, secili që mbushë këtë moshë do lirohet nga detyrat dhe përgjegjësitë në NJPB dhe kthehet në detyrat e mëhershme në institucionin përkatës". Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.1101 i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës referuar dispozitave që u potencuan më lartë të zyrtarëve publik është në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin e veçantë të këtij institucioni si dhe aktet nënligjore që derivojnë nga ky ligj i veçantë ,andaj Kolegji konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe se pretendimet e ankuesve janë të pabazuara mbi këtë bazë të specifikuar më lartë. Poashtu kolegji i këshillit nga përmbajtja e ankesës si dhe mbi bazën e provave që kanë ofruar palët, përkundër që ekziston një rregull e brendshme që rregullon këtë çështje dhe që e potencuan më lartë, por se nuk mund të vërtetohet me asnjë provë konkrete se përmes cilës formë, apo me çfarë akti administrativë janë ngarkuar me ushtrimin e përgjegjësive për përcjelljen e të burgosurve, andaj kolegji konstaton se pretendimet janë të pabazuara edhe në këtë kuptim përveç asaj që u tha më lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1009/2022, datë 22.12.2022.

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës ;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

